



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 180/4 prot.

Tiranë, më 24.02.2020

VENDIM

Nr. 25, datë 24.02.2020

“PËR

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 12, DATË 12.02.2020, TË
KOMISIONERIT PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL”**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, dhe Rregulloren “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

KONSTATOVA SE:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në zbatim të nenit 65, germa “c”, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, dispozitë e cila urdhëron përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për ata nëpunës të cilët kanë plotësuar moshën për pensionin e plotë të pleqërisë, si dhe të detyrave të lëna në Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “*Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2018*”, ka realizuar procesin e verifikimit lidhur me zbatimin e ligjit në këtë rast, në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë, përfshirë institucionin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Në kuadër të procesit të verifikimit, Komisioneri ka kërkuar informacion, i cili është raportuar nëpërmjet shkresës nr. 3955/1 prot., datë 26.08.2019, nga institucioni Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale, duke evidentuar punonjësit që plotësojnë moshën e pensionit të plotë të pleqërisë deri në fund të vitit kalendarik.

Për aparatën e ministrisë është raportuar se, megjithëse kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë, vazhdojnë ende të jenë në marrëdhënie me shërbimin civil nëpunësit:

- ***** , “Përgjegjës i Sektorit të Strategjive të Zhvillimit Shëndetësor”, ka plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë në datën 23.09.2016;
- ***** , “Specialist”, në Sektorin e Buxhetit, ka plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë në datën 03.09.2019;
- ***** , “Specialist”, në Sektorin e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit Shëndetësor, ka plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë në datën 05.12.2019;
- ***** , “Specialist”, në Sektorin e Programeve të Zhvillimit të Shëndetit Publik dhe Parësor, ka plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë në datën 09.12.2019;
- ***** , “Drejtor i Përgjithshëm i Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”, ka plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë në datën 24.12.2019.

Në vijim, në zbatim të dispozitës ligjore të parashikuar nga germa c), e nenit 65, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Komisioneri me Vendimin Paralajmërues nr. 12, datë 12.02.2020, ka vendosur:

“1. Të kërkoj nga Njësia e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, marrjen e masave të menjëhershme për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë, duke përfunduar marrëdhënien në shërbimin civil për shkak të ligjit, si dhe pasqyrimin e akteve në Sistemin Informatik të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (HRMIS) për punonjësit e mëposhtëm:

- ***** , “Përgjegjës” i Sektorit të Strategjive të Zhvillimit Shëndetësor;
- ***** , “Specialist” në Sektorin e Buxhetit;
- ***** , “Specialist” në Sektorin e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit Shëndetësor;
- ***** , “Specialist” në Sektorin e Programeve të Zhvillimit të Shëndetit Publik dhe Parësor;
- ***** , “Drejtor i Përgjithshëm” në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

2. Pozicionet respektive të punës, të raportohen pranë Departamentit të Administratës Publike si pozicione të lira dhe DAP të vijojë procesin për plotësimin e tyre sipas kërkesave të legjislacionit të shërbimit civil.

3. Kryerja e veprimeve të mësipërme, duhet të bëhet brenda 15 ditëve nga marrja dijoni për këtë vendim.

...”

Në vijim të zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin Paralajmërues nr. 12, datë 12.02.2020, “Mbi paralajmërimin e institucionit Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënies në

shërbimin civil, për nëpunësit që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë”, të Komisionerit, institucioni Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale përmes shkresës së dërguar me nr. 829/11 prot., datë 20.02.2020, me objekt: “Kthim përgjigje”, protokolluar pranë Komisionerit me nr. 180/3 prot., datë 24.02.2020, ka raportuar pranë këtij të fundit, masat e marra nga institucioni në kuadër të realizimit të detyrave të lëna në vendimin paralajmërues, si më poshtë vijon:

Njësia e burimeve njerëzore ka përfunduar marrëdhënien në shërbimin civil si dhe ka nxjerr aktin e ndërprerjes së marrëdhënieve financiare për punonjësit,

- *****, “*Specialist, në Sektorin e Buxhetit, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar*”;
- *****, “*Specialist në Sektorin e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit Shëndetësor, në Drejtorinë e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale*”;
- *****, “*Specialist në Sektorin e Programeve të Zhvillimit të Shëndetit Publik dhe Parësor*”.

Pozicionet e mësipërme janë raportuar pranë Departamentit të Administratës Publike, si pozicione të lira në planin e pranimit në shërbimin civil për sistemin e Ministrisë për vitin 2020, dhe aktualisht institucioni është në pritje të shpalljes së vendeve vakante.

Përsa i takon dy punonjësve të tjerë për të cilët Komisioneri ka kërkuar ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të plotësimit të moshës për daljen në pension të plotë pleqërie, institucioni Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka kërkuar shtyrjen e afatit për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, deri në përfundimin e procedurave ligjore për zëvendësimin e tyre dhe emërimin e nëpunësve të rinj në këto pozicione. Konkretisht bëhet fjalë për punonjësit:

- *****, me pozicion “*Përgjegjës i Sektorit të Strategjive të Zhvillimit Shëndetësor*”. Ky pozicion është shpallur vakant dhe është zhvilluar procedura e konkurimit gjatë vitit 2019, por procesi i rekrutimit është mbyllur pa fitues, për shkak se kandidatët për këtë pozicion pune duhet të jenë të diplomuar në Mjekësi. Pozicioni është përfshirë në planin e pranimit për vitin 2020, të Departamentit të Administratës Publike;
- *****, “*Drejtores e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale*. Për këtë punonjëse, e cila është anëtare e TND-së, vendimi i Komisionerit i është përcjellë njësisë përgjegjëse DAP për ekzekutim të mëtejshëm.

Në të njëjtën kohë në këtë shkresë, të dërguar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, theksohet angazhimi i këtyre dy punonjësve në detyra shumë të rëndësishme, sikurse janë, drejtimi i grupeve të posaçme, të ngritura pranë Ministrisë, për monitorimin e epidemisë së shkaktuar nga virusi i gripit në rajon si dhe viruset sezonale të gripit, që vlerësojnë

zbatimin e masave të marra nga institucionet kombëtare në varësi dhe strukturat rajonale dhe vendore, për të përballuar këtë situatë.

Gjithashtu theksohet se të dy këta punonjës, nisur nga përvoja e tyre, kanë rol kyç në grupet e punës së MSHMS për zbatimin e Programit të Rindërtimit dhe Rimëkëmbjes së dëmeve të shkakuara nga tërmeti i 26 nëntorit 2019.

Në analizë të sa më lart, në kushtet kur, nga ana e institucionit ka filluar ekzekutimi i vendimit të Komisionerit dhe ka përfunduar për 3 raste, ndërkohë që për dy raste është në proces, si dhe duke marrë parasysh faktin se, ndërprerja e menjëhershme e marrëdhënies së punës në shërbimin civil për punonjësit ***** dhe *****, do të krijonte pengesa në ecurinë normale të punës së institucionit, në realizimin e programeve tepër të rëndësishme për popullatën në këto momente, sikurse është monitorimi i epidemisë së gripit të përhapur në mjaft vende të botës si dhe në zbatimin e programit të rivlerësimit, vlerësoj se, kërkesa për shtytjen e afatit për ekzekutimin e Vendimit Paralajmërues nr. 12, datë 12.02.2020, “*Mbi paralajmërimin e institucionit Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, për nëpunësit që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë*”, të Komisionerit, për këta punonjës, nga ana e institucionit Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është e drejtë.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, kreu IV “*Rishikimi*”, nenet 144, 145 dhe 146, si dhe Rregulloren, “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

VENDOSA:

1. Të ndryshoj pikën 3, të Vendimit nr. 12, datë 12.02.2020, me përmbajtje si më poshtë:

Të shtyhet afati i ekzekutimit të vendimit të Komisionerit dhe të vijojë marrëdhënia në shërbimin civil për punonjësit:

- ***** , me pozicion “*Përgjegjës i Sektorit të Strategjive të Zhvillimit Shëndetësor*”;
- ***** , “*Drejtores e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale*;

deri në përfundim të procesit të rekrutimit për plotësimin e këtyre dy pozicioneve të punës.

2. Për këtë vendim të njoftohet Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Departamenti i Administratës Publike.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha